

Prezantim: **Pedro Ruka**

Do të mjaftonte vetëm kjo bindje e saj e brendshme, që t'i japë poezive të veta besueshmeri, origjinalitet dhe freski ndjenjash. Në kohërat e sotme, kur poezia ngatërron gjini, zemra, bindje, stile madje edhe zëra të huajtur kushedi se ku librave të pafund, tek ky libër ndjeva gëzimin se takova një shpirt unik, gjeta vetëm Florën me gjithëka të bukur kish shkruar një grua, që këngën e ka një dashuri të heshtur e të pabujshme, vetëm për shpirtin e saj.



Flora Peci

Autorja e kësaj përmbledhje me poezi lirike nuk është e panjohur për publikun. Ajo është autore e dy vëllimeve poetike të botuara më parë, "Kosova e kullave të heshtura" dhe "Shpirti im lirik në vetën e dytë", të cilat u mirëpritën nga lexuesit e shumtë, por edhe nga kritika letrare. Flora edhe në jetë edhe në botën e poezisë është origjinale. Jeton pa drojë, lufton për të vërtetën, përshkruan ngjarjet ashtu siç janë dhe siç i ndjen në shpirt. Ajo shkruan edhe kur vuan edhe kur gëzohet. Poezitë e saj janë shprehim i ndjenjave të natyrisme të cilat vijnë e radhiten në kohën dhe vendin e vet pa ndonjë ndarje periudhesh a ngjarjesh.

Përcautorën: **Mevlyde M. Saraçi**



Flora Peci "SHTIGJE JETE" POEZI

POEZI

SHTIGJE JETE

Flora Peci



Shtëpia Botuese:

QKPSHA "Gjakova"

'''

Redaktore:

Mevlyde Mezini Saraçi

'''

Kopertina:

Ismail Rexhepi

'''

Flora PECI

SHTIGJEVE TË JETËS

Prishtinë 2015



PARATHËNIE

Poezia është një ligjërimit në një mënyrë të veçantë organizimi tingullor, ku në parimet themelore të kësaj ligjshmërie është dhe ritmika e ndërsa vargu si renditje tingullore i nënshtrohet tërësisht një theksimi tonik në vëllimin poetik të Flora Pecit.

Cila është për ne, Flora Peci poete?

Flora është poezi dhe vargu i saj është poezi. Shprehuria tingullore dhe veçoritë e tingujve me një kombinim të tyre të jep mundësinë të kuptosh qëllimisht përftesat stilistikore si një lidhje alternative, jo e zakonshme dhe ky efekt të krijon një simbolizëm tingullor. Poetja që luan me limën e shpirtit, ndjenjave, boshtit humerik të dhembjeve, intonativitetit si një përcaktim për çdo kuptimësi fjale duke shquar midis tyre, ndjeshmërinë e lartë që është shoqëruese e idealit të poezive si përbërje motivesh dhe konceptesh. Skematika e poezive lypsen drejt një gjetje ndryshe, gjetje themelore për të krijuar poezinë si mëshirim i gjuhës së shpirtit ndaj emotiviteti përbën një harpë logjike të ngulitur në parafytyrimin se kemi të bëjmë me një poete që luan me motivet e ekzistencës, me ngjyrimet vargatike.

Flora është një poete që në raport me vargun e saj është e drejtpërdrejtë, krejtësisht e huazuar në tipizimet natyrale të ekzistencës, jetës, furtunave jetësore drejt ciklopizmit të metrikës me një ngjeshje të figurave mbizotëruese të hiperbolës, epiteteve, metaforave, simbolit, personifikimit që tejçojnë një

tipar idealist të poezisë me protagoniste kryesore Florën, poete. Shpërthime të fuqishme dhe tronditëse, shpërthime gjuhësore që brendësojnë shqetësime të thella ndaj problemit me luftën e ndjenjës, luftën atdhetare, luftën e çlirimit të vetvetes duke të dhënë në miniaturë vetë poezinë si një ushqim ndaj paragjykimeve njërezore si ide paralele me vetë figuracionin e këtij vëllimi dhe ndërtimit krejtësisht të natyrshëm me tendosjen e botëkuptimit dhe forcës shprehëse.

Tiparet dalluese të poezisë

- 1. Ekspresiviteti në këtë vëllim poetik mbështetet në përshtypjet zotëruese dhe trajtimit të temave sipas një këndvështrimi tejet real dhe të prekshëm për lexuesin.***
- 2. Njësitë e vogla sintaksore të cilat të japin mundësinë e realizimit të bashkimit të fjalëve me njëra-tjetrën dhe si aftësi, togfjalëshat e lirë janë të pranishme në këtë vëllim poetik të cilët mund të zbërthehen lehtë për të funksionuar si gjymtyra të vetme në poezi.***
- 3. Idetë qëndrore që shoqërohen paralelisht me përjetimet vetjake, ndjenjat, mendimet janë një proces që zhvillohen brenda vargut duke të dhënë shtojca psikologjike të kalimeve vargatike në deduksion-induksion.***
- 4. Kuptimet e përcaktuara si një kuotim në fjalitë përbërëse të vargut përshkruhen me portretizim moral të rrëfyer në metodën artistike në një drejtim më të gjërë dhe realist sesi Flora tenton të mbërthejë poezinë për t'i dhënë tipare estetike.***

Duke u përfshirë në poezinë e Pecit do të kuptojmë sesa lehtë vjen ritmika dhe niv. ideo-artistik në poezi, por që në brendësi fshehin veçori të një atmosfere poetike

duke të krijuar një skenë shqetësimesh, kahesh dhe polesh sesi lind poezia e ndjenjave duke u përngjarë hera-herës, se “pika kulmore” në poezi ka një “rrëfimtari” të brendshëm që të shoqëron gjatë leximit. Kjo tentativë që risjell Flora Peci në këtë vëllim poetik është një dukje e qartë se kemi të bëjmë me një poete që kërkon të zbulojë anët më të errëta dhe më të paqta të njeriut, ndjesitë dhe ndjenjat më të thella me një subjektivizëm që sërish në tentativë lë shijen e një poezie përjetuese. Flora Peci e lidh poezinë midis pikave kyçe të të jetuarit me botëpërjetimet e saj. E dukshme le të mbetet drejtimi dhe imagjinata se deri ku do të shkojë kjo mbërritje; në fund të një tuneli, drejt një drite të bëshme, drejt perëndimit apo do të mbesë pjesë e shpirtit të vetë Florës ? ... Kjo mbetet për tu dëshmuar pas leximit të këtij vëllimi poetik për të kuptuar Florën si poete dhe Florën si pjesë e ekzistencës njëjësore.

Adriana Istrefi - Poete & Kritike letrare



AJO DINTE...

Dinte të jetë hënë në errësirën e tij
Dinte ta lozte shkopin magjik
Dëshirën t'ia rrezatonte
Dinte thinjat t'ia ledhatojë
Nga largësia buzëqeshjen t'ia fal
Shtratin në mëndafsh dashurish
T'ia shtronte.
Dinte të nëntë plagët t'ia shëronte

E plagët e saj rridhnin gjak
Dinte çdo gjë për të
Vetëm nuk dinte...
E do...nuk e do...ai
Aq sa ajo e meritonte
Nuk e dinte...

MALLI

Zhytur në mendime
Pluhurosur nga kjo jetë e sotme
Kërkonte oxhakun e vjetër
Murin e tymosur,
Shtëllungat e duhanit të gjyshit
Odën e mbrëmjes
Kur trokiste një udhëtar në portë
Kur sofra shtrohej
Kur nëna gatuante misërniken
Kur nga magjia merrte bukën
Mëngjesin, kullotat e bagëtime
Erën e vajgurit të mbrëmjes...
Mall nga largësia
I ngopur me bulevardet
Jetën e zhurmshme
Në qytetet e huaja
Malli nuk shuhej
Nga luksozja e huaj.

MIGJENIANE

Leckosur koha përsëritet
Migjeni u ringjall
Luli i vocërr ecën në shekullin tonë
Skutave të së kaluarës
Tullumbat i kishte harruar...
I mbath Luli i shekullit tonë

Qymyri edhe më shumë shitet
Shtëllungat e harresës
Gjurmëve të kasolleve
Me fëmijë të sëmurë
Lëmoshë nga koha kërkojnë
Zotërinjtë nuk kanë kohë
Këpucët lustrjnë.

DILEMË NJERËZORE

Erdhëm në këtë botë
Hipokrizi
Jetojmë në këtë botë
Djallëzi
Plakemi në këtë botë
Pa çiltërsi
Shkojmë nga kjo botë
Pa dashuri.

GËZOHEM QË TË KAM

Gëzohem natën kur ëndrra me ty
Sytë e mi i mbyll
Përqaqimi yt i ngrohtë
Shtratin ledhaton
Ti vjen
Ti dashuron
Ti dhe unë një shpirt

Unë dhe ti një trup
Gallatë ndjenjash në mëngjes
Ty nuk të kam
Shtrati im ëndërr me ty
Agu m'i hap sytë
E jetoj ditën
Të të takoj natën që vjen
Ty
Që vjen e shkon
Nata të sjell
Mëngjesi të merr
Të pres sërish
Ty...

TI BREDH...

Bredh rrugëve pa adresë
Kampanat e dështimit bien
Ti çapitesh, nuk mund të hapërosh
Ti flet, nuk mund të përgjërohesh
Nuk të lë mallkimi nëpër shtigje pafajësie
...Çdo kund mëkat mbolle
Çdokund kund gënjeshtër trillove
Murana nëpër rrugë shprese ndërtove

TI...

Ti...
ëndrrat mos ia trazo dikujt
Ti...

Lëmoshë mos kërko

Ti...

I mbylle dyert e faljes

Ti...

Fike shandanin e mirësisë

Ti...

Ik, perëndove, afshi i dashurisë

U zbeh në fanarët e së djeshmes

Ti...

Ike mos u kthe

Ajo pluhur i vuri harresës

Dikund tjetër gjeti kështjellë lumturie

Ti bredh nëpër rrugët pa adresë

Ti...

SONTE...

Sonte kur akrepat e orës puthen

Tik-taket lajmërojnë të nesërmen plot shpresë

Do të dehem nga dollia e së kaluarës

Nuk do t'i numëroj thinjat, kanë nga një histori

Nesër do ta ndez qiririn e shpresës

Do të çapitem në shtigje me lumturi

DERI KUR?..

Langonjtë, ujqërit nëpër tokë ulërijnë

Korbat në qiell krrokatin...

Pëllumbat, qengjat, të strukur në velenxë

Helmin e langonjve nuk e bëjnë dot ballë...

Luanin në vend të pavend

Të vdekur e trazojnë
Eshtrat i pluhurosën me interesin e tyre
Lëngon FENIKSI
Prehjen e tij nuk e ka të qetë
A luhet me eshtra? A luhet me histori?
Aty te kulla ku iu këndua ninulla
Te kulla ku iu rrit shtati, aty le t'i bëhet shtrati.
Sa herë duhet vlarë e ri vlarë?
Sa herë duhet luajtur
Me histori të syrgjynosur? !!!

GJURMË

SHKELA UNË NËPËR GJURMË
SHKELËN EDHE DASHURI TË TJERA
KOHA I FSHIU, GJURMË MBI GJURMË
GJURMË TË DASHURIVE TË SHUARA
GJURMË MBI GJURMË
DASHURI TË TRILLUARA
GJURMË MBI GJURMË
ZEMRA TË PLANDOSURA.
GJURMË PA GJURMË
HESHT DASHURI
GJURMËT I FSHIU HARRESA.

PESHON FJALA JOTE

Penelopë nuk desha të jem
As Kleopatër e pritjeve për ty...

Të doja çdo çast
Dehjen e dashurisë ta pimë.
Gjethe vjeshte më shndërrove
Për një fjalë,për një mall.
Thuaje,peshon shumë
Freskoje gjethen vjeshtake
Thuaje fjalën , e pres
Më kthe në jetë
Thuaje..

TI ETJA IME

Më fëshfërin nata e vdekur
Ti ia more yjet
Më gërvisht agu i mëngjesit
Ti ia more rrezen e diellit

Më shkurtohet dita
Ti ia more bardhësinë
Më zgjatet nata
Ti ia fale errësirën
Më dhemb ëndrra
Ti ia vodhe shpresën.
TI...

More dhe shkove
Asgjë nuk fale.

MALLIN DOT S' E SHUAJ

Mall për buzëqeshjen tënde
Veson në mua me vesën e mëngjesit
S'e shuan as vesa, as riga
S'e shuan as puhiza e as shtrëngata
Eja...
Malli shuhet nga buzët tua
Jetës m'i jep kuptim
Puhizë e largët e flladit pranveror
Eja në folenë time
Të pret malli ta shuajmë bashkë...
Eja...

TRUALLI KËRKON GURIN NË VEND TË VET

Mur, urë, gurë
Mbi flamur
Përjetësinë shpirti
Nuk e gjet askund.
Boletini ninullat ia nanurisi
Në Boletin iu vu plisi...
Në VLORË flamur
Urë bashkimi ngriti...
Varret kërkojnë histori
Ismaili në Kaninë
Isa në Boletin
Shfleto, historinë
Eshtrat prehen
Ku lindi historia.

Trualli kërkon gurin në vend të vet.

TË DUA, NUK TA THEM

Të kam në bebëz të syrit, por nuk të shoh

Të kam diell, por ti nuk e di se më ngroh.

Të kam ag me vesë mëngjesore

por, nuk ta them dot.

Të kam çmenduri në ëndrrat e mia

Por i hesht nga ti

Shëttttttt...

Nuk ta them dot.

Të kam hije dashurie, më ndjek në çdo shteg

Të kam ditar jete, ti nuk e di këtë

Nuk ta them dot...

Nuk t'i them dot se me thyhen krahët

Nuk t'i them dot , më verbohen sytë

Nuk t'i them dot,

Është më mirë për dytë.

MË FAL, ËNDËRR

Më fal, nuk fle më me ty

Ti shpresat m'i trillon

Gëzimin jetëshkurtër

Ma dhuron në shtratin tim
Qepallat m'i gudulis
Çapitesh lajthitur
Nga dita më rrëmben
Në ag më ik, më tradhton
Largohu nga qepalla ime
Gjumit mos i jep hijeshi
Nuk jetoj më me ty
Jetës i jap kuptim
E kotë je për mua
Zhgënjim shpirti të pata.
Më fal ëndërr,
Por nuk të dua më....si dikur.

NË VRESHTËN E DASHURISË

Aty më dashurove, aty sytë i mbylla
Më dehu fjala jote...
Aty vola kalavesh dashurie
Aty ishim një...
Aty...
Gjarpërove nëpër shpresën time
Aty helmin lëshove
Aty mbeta vetëm
Me fjalët e pathëna që akoma prisnin
Në vneshtën tonë
Aty -tjetra mblodhi frutat e rrushit
Unë mbeta gjethe e rënë në tokë

Por... aty m'u duke edhe më i bukur

Kur ike për të mos u kthyer më

Aty...

HESHT...

Hesht, largohu,

Ik edhe nga ëndrra

Kam frikë...

Edhe aty djallëzon

Mbyll portën dhe ik

Nektar nuk jap për helm

Jetës sime nuk i dhe kuptim

Ia more Penelopës pritjen

Odise i maskuar.

DERI KUR?...

Langonjtë, ujqërit nëpër tokë ulërijnë

Korbat në qiell krrokatin...

Pëllumbat, qengjat, të strukur në velenxë

Helmin e langonjve nuk e bëjnë dot ballë...

Luanin në vend të pavend

Të vdekur e trazojnë

Eshtrat i pluhurosën me interesin e tyre

Lëngon FENIKSI

Prehjen e tij nuk e ka të qetë

A luhet me eshtra? A luhet me histori?

Aty te kulla ku iu këndua ninulla

Te kulla ku iu rrit shtati, aty le t'i bëhet shtrati.

Sa herë duhet vrarë e ri vrarë?
Sa herë duhet luajtur
Me histori të syrgjynosur? !!!

HIRI I DASHURISË

Më deshe me djallëzi
Të them dhe nuk më deshe fare
Labirinteve të jetës,kohën time e humbe
Në hi më shndërrove,tik-taket e orës
M'u ndalën për ty
Dashuri!
Kthetrat e tradhtisë I gozhdove në mua
Sorollate disa fjalë
Ndjeva se jam feniks që nuk ringjallem.

LIGËSI

Iku nga mirësia jote,të braktisi
Lotin në faqe ta shikoi me përbuzje
Gjunjëzimin tënd e përdhosi
-Ik nuk më duhesh-tha shikimi I tij
Iku në humnerën e kohës
Ligësi,moj ligësi.
Mos thirr,mos qaj ,mos lut
Nisu shtegut të ri,kërko një tjetër ardhmëri
Ligësia vdes ligësi.

KUR DASHURON POETJA

Vargun e ledhaton penës qëndisje i dhuron
Imazhin tënd mes vargjesh e lexon.
Është poetja ,në urë të shembur të pret
Të vish nga dashuritë e padashuri
Të kthehesh i lodhur, i boshatisur
Të pendohesh për kohën e humbur
Për shpresën e mekur
Për poeten e lodhur që në vargje të mbajti ty
Shkronjat nën jastëk i ruante
Flinte me tënden dashuri.

ERDHA...

Erdha si femër të çmalle me ty
Çuditërisht prisje të të hakmerrem
Përbuzjeve tua, tradhtive
Që më lëne lot në sy
Prisje baltën të ta hedh fytyrës
Jo i dashur,nuk kam fuqi.
T'i fala unë të gjitha
Erdha të të përqafoj, dashuria ime e vjetër
Duart dridheshin, gojë memece mbeta
Më shikoje siluetën e vjetër
Sërish përbalte dashurinë
Prapë shpinën ta pashë
Silueta largohej

U ktheva edhe unë
Pa përqaftimin e dashurisë së vjetër.

BUZË LIQENIT

Shëtis unë me vetminë time
Buzë liqenit të dremitur
Kërkoj atë që ma morën ëndrrat
Akullnajat dua t'i shkrij
Zemrës t'i jap ngrohtësi...
E mekur nga zhgënjimet
Me liqenin bisedoj
Valët e tij dremisin
Si në pasqyrë më vjen një siluetë
Valët pëshpëritin mes veti
Pashë se shpresë nuk më dhanë
Më mëshiruan, por nuk më panë
Ika matanë,shpirtit të syrgjynosur
I dhashë vetë shpresë...e nesërmja vjen.

GREMINË SHPRESE

Netëve ti shfaqesh në ëndërr engjëll
I shtrirë pranë meje me ledhatime të zjarra
Me dashuri Orfeu
Më fal dashuri
Tisi i shpresës, flakadan dashurie
Xixë stralli shkrep në gjumin e parë...

Mëngjesi cicëron agun
Mbështjell ëndrrat e natës në humnerë
Më zgjon nga amulli e mbrëmjes
Jeta nuk është ëndërr
Greminë dashurie fundoset
Unë humbas në të sotmen
Për të kërkuar afshin e ëndrrës
Në dritë...

NUK OFSHAJ

Dua të dehem në gjumin e parë
Qepallës lotin e ditës dua t'ia largoj
Nuk dua të dremitem në vuajtjen e ditës
Dua ëndrrës t'i rrëfhem
Nuk dua asaj vuajtjen e ditës t'ia tregoj
Dua të shtrihem në imagjinatën time
Vargut lutjet e mbrëmjes
Me muzën time t'ia thur
Vargu im !
Ti e di çfarë shkruan pena
Ti e di çfarë dua unë
Ti e di...
Dua..
Nuk dua...
Unë...nuk ofshaj më.

SI...?

Errësirës ia fala një dritë
Gjumit ia tregova ëndrrën
Dhembjes ia thashë uratën
Të mërziturit i dhashë shpresë
Të përvuajturin e ngushëllova
Me fjalë urtësie
Dashurisë ia fala dashurinë
Nuk e pranoi...
M'i rrëmbeu të gjitha
Iku pa gjurmë
Kujtimet në errësirë lëndojnë,

NUK VDESIN YJET (YLLKA DOMIT)

Qiell i hapur i mbuluar me gri
Ofshamë e nëntokës
Retë kuvendojnë.

Nënë, loti djeg, zemra në prush shndërruar
Yll Yllka u qëllua, një jetë e shuar
Për të mos vdekur kurrë.

A vriten pëllumbat ?A shuhet ylli
Në pafajësinë e fajësisë
Gërshetën e njomë
Për tokë e katandisën.

Bishë Karpatet s'i njohën yjet
Ylberit një ngjyrë ia morën
Vargun e engjëllushes ia ndalën.
Gjakova rënkoi, Kosova digjej flakë
Amanet pendën e le Yllkë
Të gjakosur e ti e plandosur.

Për këtë tokë u flijove, u bëre feniks
Prehu në parajsë o Yllkë e tokës sonë
E gjallë je, me ne dhe në ne.

NETËT E HERSHME

Dielli kur ndrinte shtratin tonë
Fëmijërinë nëna na zgjonte nga gjumi
Nanurisjet e ëndrave zhdukeshin me mëngjesin
Babai ikte herët në punë
Fëmijëria jonë rritej nga duart e tij.
Nuk jetuam kohën migjeniane
Sofër e begatë shtrohej nga duart e nënës.
Prisnin lojërat djallëzore
Gjyshja rrinte në sokakun e kalldrëmtë
Tjerrke shtëllungë leshi te portë e vjetër
Përcillte lojën tonë gazmore...
Shtëllunga përplasej në shpinën tonë
Çapkënlleku kur teprohej.
Kishte mirësi ajo kohë
Kur smira nuk kishte vend në shpirtin tonë

Kur babai vinte me duar plot nga puna
Harronim shtëllungën e gjyshes
Mblidheshim në shtëpi
Me muzgun e mbrëmjes

ERRËSIRË NË FJALË

Ishe re e errët , unë të ndritur te shihja
Qielli blu mbi horizont dashurie shtrihej
Si e marrë nuk shihja fytyrën tënde të vranët
E dehur nga aroma e dashurisë
Më dukesh reze dielli.
Amshim më quaje e unë nuk vëreja errësisë.
Nata kur erdhi, gjumi m'i rëndoi qepallat
Me dashurinë boshe fjeta
Mëngjesi më gdhiu pa ty, llahtari ne jetën time
Errësisë ishte fjala jote, re e murrme në mendjen time
Turbullirën e ndjeva vonë, atëherë kur u largove
Gjurmët i mbulove me errësisë të harresës.
Ike se ishe i lig, i boshatisur në shpirt
Errësisë
Fjala jote
Errësisë
Dashuria jonë
Errësisë jeta jote
Errësisë, më mirë hesht
Për mua dielli nuk ka perënduar
Agu i ri lindi në shpirtin tim.

I THEM VETES...

Hëna sonte pas reve qëndron
fshihet nga djallëzitë
E nuri i saj pafajësinë lëmon
Më pëshpërit ngadalë
njerëz janë të gjithë
por jo shpirti yt binjak,

Dielli rrezet do t'i falë
ylberi me ngjyra do të të mbështjell
E nesërmja të shpërblen
E padrejtësinë e djeshme e harron
Poet mund të bëhesh
por sa di të shkruash vetë
koha e tregon.

Mos i blej vargjet
e as ti mos i shit
arti lind e nuk përfitohet.
(PSEUDOPOETI)

KAM MAGJI

Kam magji, syri im të magjeps,
Me buzëqeshjen time të bëj të pendohesh,
Me mirësinë time të bëj të qash
Me guximin tim që të shikoj në sy,
Ti ul shikimin në tokë
Nga rrahjet e zemrës sime

Ti drithërohesh, tundesh nga vendi
E di se zgjat buzët të më thuash "Të dua"
Me buzëqeshje të them "Hesht"
Është më mirë për ty dhe për mua.
Mos kërkto nga yjet të ta plotësojnë dëshirën
Të jem në kraharorin tënd si atëherë
Jo se unë magjeps edhe yjet me mirësi
Mos lut as hënën se të njeh për djallëzi.
Të magjeps, e di, por nuk të lë të më afrohesh,
Aromë pranvere mbretëron në shpirtin tim
Të magjeps, por nuk të dua o acar
Akullnajë e harruar e shkrirë në pranverën time.
Kam magji, por nuk e harxhoj për ty.

KAMELEONË,O KAMELEON!

Kameleonë enden nëpër shekuj
Krekosen dhe të rrahin shpinën
E thikën e kanë mes gishtërinjsh
Nuk lebetiten, as lemerisen
Pse në fjalë nuk kanë peshore
Maskotat i kanë të lindura
Me to erdhën në këtë botë
Dhe nuk mund as të varrosen pa to.
Sa fjalë mjaltë e zemër baltë
Dinë të dredhin e të shtrembërojnë
Dinë të qajnë e të lotojnë
Dinë të gënjejnë e të përçajnë

Dinë të të hedhin në vesh vaj.
Kameleonë o kameleonë
Njëmijë fytyrash ndryshe ju thonë.
Maskota gjithmonë nuk qëndron
Se njëmijë fytyrësia shpejt larg kundërmon
A e dini se kungulli mbi ujë
Gjithnjë nuk shkon.

KJO BOTË TINËZARE...

Të jetosh dhe të thurësh ëndrra
Të imagjinosh lumturinë
Thyesh.
Përplot djallëzi janë mbushur
Fjalët e njerëzve.
Përse?
A nuk është mëkat të thyesh një zemër të pafajshme
Dhe të lëndosh një shpirt të brishtë?
Mos o njeri
Mos lejo që t'i mbushësh sytë me lot diku
Mos ia prish ëndrrat
Mos premto atë që nuk mund ta bësh
Mos humb besimin
Se njerëz jemi unë dhe ti.
Mos se bota tinëzare ka shumë pjesëmarrës
Largohu nga të këqijat
Shoqërohu me mirësinë
Do të kesh lumturi edhe ti

Mos e duaj të keqen
Flakadan mirësie
Gojëmjaltë e bamirës bëhu
Pelin mjaft ka jeta

POETËT

Janë botë në vete poetët
Janë të ndjeshëm, kanë shpeshherë siklet.
Flasin me hënën, meditojnë me qiellin
I ankohen diellit, i pyesin yjet.

I gjen edhe në petale të lules
Nektarin e saj e derdhin në varg
Që ta shijojë edhe lexuesi.

Shtegtojnë kudo
I gjen në det
I gjen në natyrë
Në çdo stinë të vitit
mbështetjen më të madhe e kanë
Nënën natyrë
Në këndin e qetë të saj
Shprehin vargje me penë
Që dalin nga shpirti i tyre i dëlirë
E bëjnë lexuesin
Të ndjehet çdoherë mirë.
Ndaj...kujdes ndaj tyre se janë si kristal
Po i prekët në shpirt
Loti do t' iu dalë.

SA FYTYRA KE?

Kur të nevojitem
Shpërndan ëmbëlsi
Oksigjen të jetës
Më thua të kam ty.
Hahahaha qeshem unë
Kur më duhesh
Ti ke shumë punë

SA FYTYRA KE?

Kur të nevojitem
shpërndan ëmbëlsi
oksigjen të jetës
më thua të kam ty.
Hahahaha qeshem unë
Kur më duhesh
ti ke shumë punë
e nuk më ke më
as bakllava e as pëllumb.
Bëhesh zyrtar, mban veten krenar
krenari e imagjinuar
e një hiçi iluzionesh
po ik në djall të mallkuar.
I do vetë gënjeshttrat e tradhtitë
tjerëve u thua se këto shumë i urren
aq të bën ty, ndërgjegjja s'të bren.
Perëndove
ik se nuk ka më oksigjen
bakllava e llokum

nuk do të shiten më askund.
së paku jo tek unë

EJA SONTE

Errësira mbuloi qytetin
Velenxë e turbullt mbi çati
Eja se jam e ndrojtur
Nuk e dua perëndimin
lindja filloi me ty.
Në lindje u takuam
Dielli shoqëronte takimet tona
Eja sonte, ëndrra ime
Ma bëj natën lindje.
As yje nuk shoh në qiell
Qielli sonte nuk më do
Eja princ i ëndrrave të mia
Dashuria mund të lind sërish...
Eja sonte, bëhu yll i natës sime
Lindjen e diellit e presim të përqafuar.
Eja!

BUZËQESH

Buzëqeshi jetës,
Që të të buzëqesh edhe ajo ty
Dikujt kur t'i flasësh, shikoje drejt në sy
Aty lexohet çfarë ke ne brendi.
Mos puno me dinakëri
Herët a vonë të kthehet me pabesi.

Timonin e jetës
Në dorë e ke ti
Ti duhet ta drejtosh
E jo ai ty.
Ndhimjoju shokëve së paku me një fjalë
Se e mira në shesh shumë shpejt do të dalë

KRENARË PËR BACË ISËN

Lashtësia të solli me plëng e me fis
Nga Isniqi në bjeshkët e Shalës
Aty koburja jote të pret me mall
Aty shkëmbinjtë thërrasin
Të presin me mall.
Të përmend historia në Londër dhe në Vlorë
Eja le të gëzohen kësulëbardhët
Bjeshkët gjëmojnë e në kulla të heshtura kumbon jehona
Eja sërish në trojet tona.

KUR NDJENJAT GËRSHETOHEN

Përpëlit koha dallgët e jetës
Të sjell lotin, ta humb buzëqeshjen
Sot je këtu e nesër atje
Fëshfërimë e sfidës
Bëhu gati se jeta nuk ka çati
Mendimet të gërshetohen
Urrejtje dhe dashuri

Cilën ta përcjell
M'i trego hapat o jetë
Urrejtjen e meritoi
Plandosi UN-in tim
Por shkëndija dashurie
Ende shëtisin në mua
Dromcat e së kaluarës
Ende i shoh në mjegullnajë
Hapat e lehtë të dashurisë bonjake
Unë dashurova për të dytë
E dikush urren për më shumë.
Gërshetim ndjenjash
Të varura në medaljen e jetës
JO!!!
Unë jam VETJA
Nuk i lë gërshetimet
I çrrënjës nga medalja ime
E marr vetëm atë të bardhën
Mua më takon
Largoj, sfidoj dhe më nuk gërshetoj
Ndjenja hareja në mua do të mbijetojë.

KUR SHPRESA SHUHET

Kur ëndrrat shuhën dhe shpresat faniten brenda teje
Kur mendon se shkëndijë e fundit më nuk shkrepnin
Mos u dëshpëro
Dhembja nuk ka vend, lotin fshije në sy

Ylber ka për të gjithë,ylli shndrit për çdo njeri.

Vjen fshehurazi symbyllazi nga ëndrra të zgjon
Afshe përqaqimesh zemrat kaplojnë
Dashuria fillon aty ku ka mbetur
Përqaqimi i zjarrtë kurorëzon vellon e dashurisë
Zemrat bëhen një e ora e ndalur
Rifillon tik-taket, aty ku janë ndalur.

KUR VYSHKET NJË LULE...

Lulëzon dhe me aromën tënde
Çelin lule të njoma përreth
Sa i do ti dhe për to jeton
Por...
Kur fillon të vyshkesh, largohesh
Përgjithmonë në rrugën e pa kthim
Në rrugën ku mendon se sërish
Do të kesh lulëzim
E ajo rrugë të sjell të mbyllur
Me gjithë shpresat tua
Gonxhet qajnë se të pritën të tillë
Shpresën e kishit të përbashkët
...U shua edhe buzëqeshja e fundit e pritjes
U shndërrua në lot.
Dhe fjalë se do të kthehesh te gonxhet tua
Do t'u falësh ngrohtësi dhe dashuri
Se të vyshkurit të kish rënduar shpirtin

Me lule rrethuar të ujitura me lot gonxhesh
Do të mbulohet trupi yt i ri.
Zot, falu durim e sfidë gonxheve
Të pambrojtur e ndjejnë veten
Fuqia jote, mund t'i gjallërojë.
Të lutem o ZOT!!!..

LAPIDAR DASHURIE

Aty u takuam, rastësia na bashkoi
Te lisi i gjatë ti më pushtove atë natë.
Lindi një dashuri, yjet na kishin lakmi
Lisi krenohej me dashurinë tonë
Me fjalët e ëmbla që u gdhendën aty
Po lisi plak sikur më pëshpëriste
të kem kujdes nga ti.
Gurgullima e ujëvarës gumëzhinte
E humbte pëshpëritjen e lisit
Zemrat tona rrihnin në një
Yjet shndrisnin e ne të lumtur
Agun e prisnim.
Atëherë yjet humbën shkëlqimin
Atëherë më ujëvara nuk gumëzhinte
Atëherë edhe lisi heshtte
Atëherë kur me tjetrën vazhdove
Dashurinë që mua ma premtove.
Por s'të pranoi lisi plak
Ujëvara e yjet e natës

U trishtuan nga lotët e mi
Nga hiri i dashurisë që mbet nga ti.
Aty kam ngritur lapidarin e dashurisë
Ai është i përjetshëm, atë e vizitoj
Kur aty qëndroj, ujëvara më bën shoqëri
Lisi plak hesht me dhembshuri
"Të thashë moj bijë se nuk është ai për ty".
E lexoj fjalën e gravuar në lis
E kuptoj gjuhën e tij
Lapidar aty unë ngrita
Aty nuk erdhe më ti
Aty më nuk vjen asnjë njeri.

LERMË TË QAJ

Mos ma fshij lotin se tjetri pret të pikojë
Mos më ngushëllo me fjalë boshe
Ndjenjat m'i prangose
Zemrën në copëza të vogla e thërrmove
Tani lotin mos ma fshij.
Lëre të ec se ai e di rrugën e vet
Më mirë se ti që ke rënë në humnerë
Dhe tani vjen të ma fshish lotin.
Ke perënduar atëherë kur ike
Shkëndijën e shpresës e shove në mua
Prush le në ndjenjat e mia
Tani u ktheve të kërkosh falje
Ik nga ke ardhur se loti nuk të fal.

MBAJE PREMTIMIN

Nëse premtion, mendo para se ta thuash fjalën,
Premtimi ecën në vesh të atij që pret,
Mos e gëzo me fjalë boshe,
Mos luaj rolin e të mirit,
Se e vërteta del shpejt në shesh,
E thyen një zemër se ajo shpreson,
Është gotë e thyer nëse edhe ti e mashton.
Mbaje premtimin, bëje atë që e ke thënë,
Se-nëse ke ndërgjegje o njeri,
Ajo natën llahtarshëm do të përkujtojë,
Ngrihu o i bekuar se premtimi bosh
Në jetë të mallkon.

MË HUMBE NË SY

Shkëndijë lumturie në sytë e mi
Ishe ai që ëndërroja
Përqaftimi yt ylber pas shiut
Dashuria na përqafoi në një trup...
Netëve te gjata ishe ëndrra ime realitet
Të shihja, të prekja, të doja
Unë dhe ti në përqaftim
Tik-taket e orës përcillnin rrahjet e zemrës
Shiu nga jashtë fshihte psherëtimat tona
Dashuria me zjarr ndizej...

Por...

Nuk zgjat shumë ajo që është e bukur...

Rruga të thirri dhe ëndrrat u shuan

Nuk ta thashë lamtumirën se është trishtim

Nuk ma pa lotin as shikimin e mallëngjyer

Nostalgjinë e mbylla ne vete

Lotin e lashë për më vonë...

Bredh ëndrrave sërish me ty

Me shpresë se sërish do të ëndërroj në realitet

Te dua me të gjitha që ke

Edhe kapriçet, edhe buzëqeshjen

Dhe...

Të pres te vazhdojmë aty ku kemi mbetur

Së bashku ta thurim rrjetin e merimangës

Fati të na mbështjellë në të

Mua dhe ty... dashuria ime.

ME SHPRESËN U ZGJOVA

Ëndrra e trishtë më hodhi në mjegullinë

Rrugëve të errëta më përplasi

Ishte e pamëshirë.

Më rrëmbeu nga shtrati i shpresave të mia

Më futi në errësirë të pamëshirë.

Sy mbyllur ëndrrën e largova

Nuk dua të zgjohem me teket tua
Nuk jam ajo që ti mund të luash me mua
E trishtë je, shpresën mos ma rrëmbe.
E kam shoqe dhe nuk më lë të vetmuar
Shkëndijë lumturie në shtigjet e mia
Ti e llahtarshme ik nga shtrati im
Tek unë nuk ke strehim.
Princ në kalë të bardhë është e imja shpresë
Në mëngjesin e hershëm, atë e kam pikë vesë.
Me të shëtis, meditoj në të bukurën
Llahtarinë e nëpërkëmba unë
Shpresën e kam engjëll mbrojtës
Puhizë e të nesërmes sime.

MEDITIM NË VARGUN TIM

Vargu im më përqafo,
Më jep qetësi
Simfoninë e natës së errët
Ma shndërron në ag diellor
Jetës m'i jep shpresë
Vargun tim nuk e lë të vdes.
Meditoj thellë në brendinë e tij
Gjej çdo gjë që dua
Të djeshmen e të sotmen
Dhe me to thur ëndrra për të nesërmen
Vargu im nuk më lë të vetmuar.
Edhe unë kur nuk dua

Ai dashuron për mua...
Mimozat në vargun tim lulëzojnë
Ujiten me pendën, me vargun e mëngjesit
Ai ia përcjell muzën vargut të mbrëmjes
Në mesnatë lulëzon një vjershërim.
Meditoj në vargun tim
Nuk më tradhton ai mua.
Ma merr loti, buzëqeshjen
I shkrin në katër vargje
Sakaq muza ngritët
Nuk më lë të rrëzohem
Vargu im, bastun i jetës
Vargu im, shpresë e ditës
Vargu im, djepi i natës.

MES FJALËSH, OFSHAMË

Dua t'i zbraz të gjitha dhembjet
Në shpirt ato më ndezin prush,
Por nuk mundm nga ofshamat
Ato ma ndalin fjalën në gushë.
Nuk më lënë të zbraz kupën e helmit
Më lënë fjalë cinguar e zemër lënduar
Në buzë çarje humbasin
Në hapësirë ato zbehen
Nuk kanë fuqi të dalin e ta marrin dhenë.
Jo!!!
Nuk të lë ofshamë të më dalësh më në rrugë

Do të shemb ty dhe do t'i zbraz helmet e kupës sime

Do të mbështillem me afshin e bukur të dashurisë

Që e ka emrin JETË.

Do ta qëndis me fije mjaltë fjalën time

Ti nuk rri aty ku mbretëron hareja

Buzëqeshja siluetë do të më bëhet

Atëherë kur ti del nga unë.

MISHËRUAR ME NARCISOIZËM

Sa teket të erdhën në kokë

Kurorë i vure vetes

I lulëzove shtigjet, kopsht nuk kishte askund

Kurorëzove vlera të pavlera

E vetëquajte veten ikonë.

Hipe në qiell, nuk bëhesh dot parashutë

Bie nga lart e shembesh

Mirënjohjet e imagjinuara të bien përtokë

Janë letër e ti je njeri.

Të vlerësojnë të tjerët

Narcisoizmin lëre anash të pushojë nga ti

Nëpër dekada nuk e le të qetë

E shëtite të gjorin ti me kokën lart.

Lëre të shkretin e mos u mishëro me të

Ji vetja, mos aktro të famshmin

Unë, unë dhe vetëm unë...
Nuk je ti dhe vetëm ti
Janë të tjerët që të njohin
Ty me vetëkënaqësinë tënde...
Shkel në tokë, mos fluturo në qiell
Me dorë nuk mund të prekësh në diell
Në theqafje shkon
As Zoti s'të ndihmon.

MESJANARI I REÇAKUT

Skëterrë, gjëmë, jehonë vrasje makabre
Pellgjeve të pafajësisë
Emri SHQIPTAR në Reçak
U vra për t'u shndërruar në feniks.

O Zot, na bëj të fortë emri ynë përse i mallkuar?
Vrasje makabre e kanibalëve të harbuar
Në tokën tonë, o bishë e tërbuar.

Reçakun e pa bota dhe botës i kumboi
Kambanat e dhembjes kumbojnë dhimbshëm në Kosovë...
Zgjoheu botë, vritet pafajësia...

Sy të kthyer kah qielli pëshpërisnin kufomat...
"Mos lotoni, liria ju vjen"..
Nënë sa gjak u derdh, u njom një Kosovë...

Përballë lotsyri përzihej me gjakun...
Qielli rënkonte, toka çahej...
I mori në gjirin e saj të acartë
Të ngrohen me erën e nënës tokë...

MEDET!!!

Dhe bota i tregoi botës,dhe bota erdhi këtu
Panë kombin tonë të vrarë
Panë gjëmën e popullit jo mëkatar.

Reçak! Për të pesëmbëdhjetën herë të falim lule,
Për të pesëmbëdhjetën herë ti ringjallesh
Edhe sot lule e lot krenarie
Reçak...ti na e solle lirinë...
Vëllezër, prehuni në qetësi
Homazh për ju, një e madhe
LAVDI!!!

MOS MË PYET...

Mos pyet përse në dhomën time
Sonte nuk është fikur drita
Heshtja flet vetë
Errësira më përkujton ne ty
Sonte jam e dehur nga djallëzitë tua
Mos pyet a kam lot në sy
Ai rrëshqet sonte vetë
Mos thuaj të fillojmë sërish

Nuk dua prangosje ndjenjash me ty
Pres mëngjesin
Atëherë fik dritën, vesa më jep shpresë
Errësirën e lashë me ty...
Unë zgjohem nga Ilahtaria
Sfidoj edhe njëherë...
Mos fol për pendim
Atë e kam gjunjëzuar
Nuk vlen më asnjë fjalë jotja
E maskuar me njëqind fytyra
Ik dhe mos me pyet asgjë
Nuk kthej kokë prapa, ti je aty
Mos...
Mos.
MOS...

MOS MË THUANI

Hënës ia rrëmbeva nurin u vasha në petkun e saj
Diellit ia kërkova një cep rrezeje
Të jem e jotja mbretëreshë
Dashuria ime.

Nata më mbështolli me pelerinë errësire
E përgjumur e pagjumë
Prisja të më vije në portën e shpresës
Prisja..

Agu më përshëndeti, vesa ma lëmoi fytyrën
Hënës ia ktheva nurin, në rreze dielli vetë u shndërrova

Mbretëreshë e jotja nuk u bëra

Mos më thoni të dashuroj, oqean vuajtjesh

Mbolli ajo në mua

Mos më thoni të fal rrugën e pa kthim

Mos më quani vrastare të dashurisë

Ajo më vrau mua.

Mos më fajësoni mua

Kështjellë muranë pa mbretëri

E shihni lotin tim?

Më vrau një dashuri.

Mos më thoni...

HESHT...

Mos thuaj se u pendove kur mua më plandose

Mos u beto në dashurinë tonë

Asaj i thoshe feniks dhe përjetësi

Çmendërisht të besova, në mjegullnajën e dashurisë

Në rrjetin e labirintit të lajkave tua

Qëndroja si e marrë

Dehesha nga premtimet tua

Symbyllur i dëgjoja, gojëhapur mbetësia

Rrokullisej lot gëzimi

E ti djall i përjetshëm, këtë nuk e vëreja

Nuk e ndjeva erën e fund ferrit

Beatrice më quajta atëherë

Po nuk të imagjinoja se je skëterrë.
Je larg dhe nuk të imagjinoj më
Ee largët është dashuria ime
Perëndoi me tradhtinë tënde
E unë linda sërish
Nuk jam më Beatriçja jote
Mos kthe kokën të më shikosh
Dhe falje të kërkosh
Është vonë, shumë vonë
Jam unë që e ndjej larg fund FERRIN
Jam unë që valëvitëm në shtigjet e lumturisë
E ti hesht dhe vazhdo me djallëzi
E unë qepallë nuk lëviz nga shikimi yt
Neveritje në jetën time
Shumë shpejt në harresë të palosa
Drejt shtigjeve të shpresës
Shpejt u vendosa.

VALLË?

Ç'është ky gabim vallë?
Që të shqetëson me aq mall?
Diellin pse po e shoh kaq rrallë?
E çdo gjë më sillet vërdallë?

MOS...

Mos thuaj se u pendove kur mua më plandose
mos u beto në dashurinë tonë

asaj i thoshe feniks dhe përjetësi
çmendurisht të besova, në mjegullnajën e dashurisë
në rrjetin e labirintit të lajkave tua
qëndroja si e marrë
dehesha nga premtimet tua
symbyllur i dëgjoja, gojëhapur mbetesha
rrokullisej lot gëzimi
e ti djall i përjetshëm, këtë nuk e vërejta
nuk e ndjeva erën e fund ferrit
Beatrice më quajte atëherë
po nuk të imagjinoja se je skëterrë.
Je larg dhe nuk të imagjinoj më
e largët është dashuria ime
perëndoi me tradhtinë tënde
e unë linda sërish
Nuk jam më Beatriceja jote
mos kthe kokën të më shikosh
dhe falje të kërkosh
është vonë, shumë v
mbaj timonin në dorë
thith nektarin e ëmbël
shijoj jetën e çiltër e plot hare
nuk kthej kokën prapa
se pluhuri m'i verbon sytë.

SHARKIA E GJYSHIT

Në murin e vjetër, të tymosur

Hijerëndë varet një sharki
Shumëherë telat i kishte dridhur
Për shumë heronj kishte kënduar
Për traditën e të parëve
Shumë të rinjve i u kish treguar.
Gjuhën shqipe të stërgjyshit
Me zë bilbili e kishte thënë
Mos harroni bijtë e shqipes
Se në djep e dëgjuat këtë cicërimë
Në dhe të huaj mos mësoni gjuhë të akullt
Se ajo nuk tingëllon ëmbël
s'ka askund si fjala shqipe
Që të ngroh ty në zemër.
E shikoja atë sharki
Telat ndryshkur shumë më treguan
Gjyshi plak la amanet
Që aty ajo të qëndrojë
Se ka edhe shumë të na tregojë.
Thotë se pret të ndalen përçarjet
Atyre të kolltukëve t'u humbet fara
E populli ynë të shkojë përpara.

ZOT, TË LUTEM!

Sonte kur qielli qan e toka rënkon
Sonte kur shumë shpirtra shkuan lart në qiell
Sonte dora nuk më shkruan dot poemë dashurie
Sonte edhe ajo dridhet kur thur vargje.
Të lutem o ZOT, bëje të lehtë dhembjen

E atyre që i humbën,
E atyre që as nuk ëndërruan as nuk menduan
Se arkivolet do të vijnë në shtëpitë e tyre...
oh, të lutem, forcoji zemrat e lënduara
jepu forcë e durim...
Lotët na tradhtojnë ne që s'i njohëm,
Po sa dhembje ndjejnë ata që i patën në shtëpi
Ata që pritën të marrin nuse dhe të japin vasha...
Të lutem o ZOT ndihmo!!!...

MOS MENDO

Mos mendo se të kthehem
Edhe nëse ti kokulur një ditë
Do të vish papritmas të kërkosh falje
Mos mendo se do të mashtrohem
Dhe e di se nuk do të pendohem
Nëse lulen nuk ta pranoj
Nëse fjalë nuk shqiptoj
Mjafton një shikim nga ti
Dhe me një heshtje e nënqeshjetë të bind se më nuk të
dashuroj.
Ike kur pata nevojë për ty
Kur jeta ime në vaj u shndërrua
Tash kur e ktheva lumturinë
S' më duhesh kurrë më mua.

MONOLOG ME VËLLANË TIM AFRIMIN TË VRARË NGA FORCAT SERBE

Sonte lërmëni të jem vetëm.

Më pëlqen kështu.

Sonte bisedoj vetëm me ata që më shikojnë nga qielli,

Lotin e fshiva se nuk më duan të tillë.

Sot me kurora lulesh ua stolisa varrin, por nuk biseduam.

Urova, por heshtën, nuk më falënderuan.

M'u duk se janë më të qetë se ne që jetojmë në këtë tokë me

Rrënjë hipokrizie,

Nuk munda ta kthej shpinën dhe të largohem,

Por m'u duk se dëgjova një jehonë të përmbytur

"Shko, ik, mendoni në gjakun tonë që e dhamë për këtë tokë
që e shkëlpi ju sot.

Mos shkëlpi me të këqija nëpër gjurmët e gjakut se ato janë
plagët e lirisë."

Më pikoi loti, hodha edhe një tufë lulesh dhe eca me hapa të
shpejtë që të mos më tradhtojë sërish loti.

Ishte amaneti i të rënëve.

Ndaj sonte e dua vetminë dhe do të jem vetëm me ata që
Jetojnë në qiell.

Më shoqëron nuri i hënës, por edhe ai hesht.

Bashkë numërojmë yjet dhe heshtim....



© Pashtriku.org, Janar 2016